



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Seanca plenare e Kuvendit
P-071
Prishtinë, më 4 dhe 5 gusht 2016

P R O C E S V E R B A L

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 4 DHE 5 GUSHT 2016**

Seancën e drejtoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, ndërsa i ndihmuan Xhavit Haliti dhe Fikrim Damka, nënkryetarë të Kuvendit.

Kryetari i hapi punimet e seancës plenare sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën këta deputetë: Bislim Zogaj, Albin Kurti, Slavko Simiq, Mufera Shinik, Hajdar Beqa, Glauk Konjufca, Gëzim Kelmendi, Adem Grabovci dhe Fikrim Damka, të cilat janë dhënë të plota në transkript.

Zëvendëskryeministri dhe ministri i Kulturës, z. Kujtim Shala, në emër të propozuesit, mbështetur në nenin 56.5 të Rregullores së Kuvendit, e tërhoqi Projektligjin nr. 05/L-050 për kinematografinë nga procedurat parlamentare.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti Raif Qela i parashtrroi pyetje kryeministrit të Kosovës, Isa Mustafa, lidhur me procedimin e projektligjit për Trepçën.

Kryeministri i Kosovës, Isa Mustafa, nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Ismajl Kurteshi i parashtrroi pyetje kryeministrit të Kosovës, Isa Mustafa, lidhur me bazën ligjore për përfshirjen e 483 ish-pjesëtarëve të strukturave ilegale të Serbisë në sistemin e pagave nga janari i këtij viti, edhe pse ata nuk janë të punësuar?

Kryeministri i Kosovës, Isa Mustafa, nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Sala Berisha-Shala i parashtrroi pyetje ministrit të Infrastrukturës, Lutfi Zharku, lidhur me ndërtimin e rrugës Skenderaj-Komoran.

Ministri Lutfi Zharku iu përgjigj deputetes Sala Berisha-Shala.

Deputeti Ismajl Kurteshi i parashtrroi pyetje ministrit të Infrastrukturës, Lutfi Zharku, lidhur me sinjalizimin, asfaltimin dhe riasfaltimin e rrugëve, si dhe mungesën e mbikëqyrjes së punimeve.

Ministri Lutfi Zharku iu përgjigj deputetit Ismajl Kurteshi.

Deputetja Puhije Demaku i parashtrroi pyetje ministrit të Punëve të Jashtme, Enver Hoxhaj, lidhur me vendimin e Qeverisë së Norvegjisë që shqiptarëve të Kosovës, me shtetësi norvegjeze, në pasaportat e tyre vendi i lindjes u shënohet “e panjohur”, edhe pse ata kanë adresë të vendit se në cilin qytet kanë lindur në Kosovë.

Ministri Enver Hoxhaj iu përgjigj pyetjes së deputetes Puhije Demaku.

Deputetja Salihe Mustafa i parashtrroi pyetje ministrit të Shëndetësisë, z. Imet Rrahmani, lidhur me licencimin e profesionistëve shëndetësorë.

Ministri Imet Rrahmani iu përgjigj deputetes Salihe Mustafa.

Deputetja Mexhide Mjaku-Topalli i parashtrroi pyetje ministrit të Arsimit, z. Arsim Bajrami, lidhur me formimin e ekipeve profesionale për vlerësim në komuna, si dhe shërbimeve këshillimore shëndetësore për nevojat sociale nëpër shkolla.

Ministri Arsim Bajrami iu përgjigj deputetes Mexhide Mjaku-Topalli.

3. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme

Kuvendi i miratoi pa vërejtje procesverbalet e seancave plenare, të mbajtura më 7, 8 e 11 korrik 2016 dhe më 14 korrik 2016.

Deputetja Xhevahire Izmaku pati vërejtje në procesverbalin e seancës plenare të datës 17 qershor 2016, ngase nuk ishte përfshirë emri i saj dhe i disa deputetëve të tjerë që kishin diskutuar lidhur me Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes ndërkombëtare në mes të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi Misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë.

Procesverbali i kësaj date është korrigjuar sipas vërejtjes së lartshënuar.

Kryetari i Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë dhe Tregti, Muhamet Mustafa, propozoi që në rend dite të hyjnë edhe dy pika shtesë:

Projektligji nr. 05/L-110, për kamatë-vonesat dhe transaksionet tregtare dhe Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për rregullat e komunikacionit rrugor.

Kryesuesi e hodhi në votim propozimin e kryetarit të Komisionit për Zhvillim Ekonomik.

Kuvendi me shumicë absolute vendosi që në rend dite të kësaj seance të radhiten edhe këto pika:

Projektligji nr. 05/L-110, për kamatë-vonesat dhe transaksionet tregtare, Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për rregullat e komunikacionit rrugor.

Kryetari i Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport, Nait Hasani, propozoi që në rend dite të kësaj seance të radhitet edhe Projektligji për ratifikimin e Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Prishtinë dhe Ministrisë së Arsimit të Republikës së Kosovës, për Programin Fulbrajt të shkëmbimit akademik.

Kryesuesi e hodhi në votim propozimin e kryetarit të Komisionit për Arsim.

Kuvendi me shumicë absolute vendosi që në rend dite të kësaj seance të radhitet edhe kjo pikë:

Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Prishtinë dhe Ministrisë së Arsimit të Republikës së Kosovës, për Programin Fulbrajt të shkëmbimit akademik.

4. Votimi i raportit vjetor të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2015

Kryetari i njoftoi deputetët se diskutimet për këtë pikë kanë përfunduar në seancën plenare të mbajtur më 14 korrik 2016. Në mungesë të kuorumit, votimi i kësaj pike është shtyrë. Andaj, në seancën e sotme u procedua vetëm votimi saj.

Kryetari e hodhi në votim raportin vjetor të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2015.

Rezultati i votimit ishte si në vijim:

Për -----	89,
Kundër-----	0,
Abstenime-----	0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi njëzëri

V E N D O S I:

Miratohet raporti vjetor i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2015.

5. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Prishtinë dhe Ministrisë për Arsim, Shkencë dhe Teknologji të Republikës së Kosovës, Programi Fulbrajt i shkëmbimit akademik.

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni FunkSIONAL për Arsim e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim, me 3 amendamente të propozuara.

Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Arsim Bajrami, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi Projektligjin për ratifikimin e Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Prishtinë dhe Ministrisë për Arsim, Shkencë dhe Teknologji të Republikës së Kosovës, Programi Fulbrajt i shkëmbimit akademik.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin e këtij projektligji.

Lidhur me Projektligjin për ratifikimin e Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Prishtinë dhe Ministrisë për Arsim, Shkencë dhe Teknologji të Republikës së Kosovës, Programi Fulbrajt i shkëmbimit akademik, diskutuan: në emër të Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport, Nait Hasani, në emër të GP të PDK-së, Bekim Haxhiu, në emër të GP të LDK-së, Salih Morina, në emër të GP të LVV-së, Ismajl Kurteshi, në emër të GP LS, Slavko Simiq, në emër të GP “6+”, Qerim Bajrami, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pastaj, kryetari i hodhi në votim amendamentet e propozuara një nga një.

Kuvendi i miratoi amendamentet 1, 2 dhe 3.

Në fund, kryetari e hodhi në votim projektligjin me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte si në vijim:

Për -----	87,
Kundër-----	0,
Abstenime-----	0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi njëzëri

V E N D O S I:

Miratohet Projektligji për ratifikimin e Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Prishtinë dhe Ministrisë për Arsim, Shkencë dhe Teknologji të Republikës së Kosovës, Programi Fulbrajt i shkëmbimit akademik.

6. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes së kredisë ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe UniCredit Bank Austria AG për financimin e projektit të modernizimit të shërbimeve të Kardiologjisë Invazive në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale e kanë shqyrtuar këtë projektligj dhe Kuvendit i kanë rekomanduar për miratim.

Ministri i Financave, Avdullah Hoti, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes së kredisë ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe UniCredit Bank Austria AG për financimin e projektit të modernizimit të shërbimeve të Kardiologjisë Invazive në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin e këtij projektligji.

Lidhur me Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes së kredisë ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe UniCredit Bank Austria AG për financimin e projektit të modernizimit të shërbimeve të Kardiologjisë Invazive në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës diskutuan: në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, Naser Osmani, në emër të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, Flora Brovina, në emër të GP të PDK-së, Fadil Beka, në emër të GP të LDK-së, Hatim Baxhaku, në emër të GP të LVV-së, Besa Baftija, në emër të GP “6+”, Fikrim Damka, si dhe deputeti Bekim Haxhiu, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Në fund, kryetari e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.

Rezultati i votimit ishte si në vijim:

Për -----	87,
Kundër-----	4,
Abstenime-----	1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash,

V E N D O S I:

Miratohet Projektligji për ratifikimin e Marrëveshjes së kredisë ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe UniCredit Bank Austria AG për financimin e projektit të modernizimit të shërbimeve të Kardiologjisë Invazive në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës.

7. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes përkitazi me themelimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni për Punë të Jashtme ka shqyrtuar Projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes.

Ministri i Punëve të Jashtme, Enver Hoxhaj, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes përkitazi me themelimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin e këtij projektligji.

Lidhur me Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes përkitazi me themelimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor diskutuan: në emër të Komisionit për Punë të Jashtme, Teuta Rugova, në emër të GP të PDK-së, Blerta Deliu-Kodra, në emër të GP të LVV-së, Puhije Demaku, në emër të GP “6+”, Qerim Bajrami, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Në fund, kryetari e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, në mungesë të votave të mjaftueshme, nuk e miratoi Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes përkitazi me themelimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor.

8. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes financiare ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime për projektin e rehabilitimit të linjës hekurudhore 10

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Ministri i Financave, Avdullah Hoti, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes financiare ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime për projektin e rehabilitimit të linjës hekurudhore 10.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin e këtij projektligji.

Lidhur me Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes financiare ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime për projektin e rehabilitimit të linjës hekurudhore 10 diskutuan: në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, Besa Gaxheri, në emër të GP të PDK-së, Labinote Demi-Murtezi, në emër të GP të LDK-së, Ismet Beqiri, në emër të GP të LVV-së, Glauk Konjufca, si dhe deputetët Besim Beqaj, Ali Sadriu dhe Bekim Haxhiu, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryetari e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.

Rezultati i votimit ishte si në vijim:

Për -----	85,
Kundër-----	0,
Abstenime-----	0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi njëzëri

V E N D O S I:

Miratohet Projektligji për ratifikimin e Marrëveshjes financiare ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime për projektin e rehabilitimit të linjës hekurudhore 10.

9. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes së garancisë ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin e Trafikut Urban

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes së garancisë ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin e Trafikut Urban dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim, bashkë me amendamentet e propozuara.

Për të diskutuar lidhur me shqyrtimin e Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes së garancisë ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin e Trafikut Urban nuk u paraqit askush.

Kryetari i hodhi në votim amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL një nga një.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4 dhe 5.

Kryetari e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.

Rezultati i votimit ishte si në vijim:

Për -----	83,
Kundër-----	0,
Abstenime-----	1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash

V E N D O S I:

Miratohet Projektligji për ratifikimin e Marrëveshjes së garancisë ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin e Trafikut Urban në Prishtinë.

10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për performancën energjetike në ndërtesa

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni FunkSIONAL e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

U.d. i ministrit të Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, z. Ferat Shala, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi Projektligjin për performancën energjetike në ndërtesa.

Kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin e këtij projektligji.

Lidhur me Projektligjin për performancën energjetike në ndërtesa diskutuan: në emër të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural dhe Planifikim Hapësinor, Adem Salihaj, në emër të GP të PDK-së, Emilija Rexhepi, në emër të GP të LDK-së, Sadri Ferati, në emër të GP “6+”, Mufera Shinik dhe deputeti Zenun Pajaziti, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Ky projektligj është votuar në vazhdimin e seancës plenare më 5 gusht 2016.

Kryetari e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.

Rezultati i votimit ishte si në vijim:

Për -----55,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 8.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash

V E N D O S I:

1. Miratohet në parim Projektligji për performancën energjetike në ndërtesa.
2. Ngarkohen Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtjen e fëmijës

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni FunkSIONAL e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

Ministri i Punës dhe i Mirëqenies Sociale, Arban Abrashi, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi Projektligjin për mbrojtjen e fëmijës.

Kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin e këtij projektligji.

Lidhur me Projektligjin për mbrojtjen e fëmijës diskutuan: në emër të Komisionit FunkSIONAL, Lirije Kajtazi, në emër të GP të PDK-së, Mexhide Mjaku-Topalli, në emër të GP të LDK-së, Lirije Kajtazi, GP të LVV-së, Mytahir Haskuka, GP të LS-së, Slavko Simiq, në emër të GP “6+”, Kujtim Paçaku, si dhe deputetët: Xhevahire Izmaqu, Njomëza Emini, Albulena Haxhiu, Salihe Mustafa, Gëzim Kelmendi, Zenun Pajaziti dhe Flora Brovina, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Ky projektligj është votuar në vazhdimin e seancës plenare më 5 gusht 2016.

Kryetari e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.

Rezultati i votimit ishte si në vijim:

Për -----61,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 10.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash

V E N D O S I:

1. Miratohet në parim Projektligji për mbrojtjen e fëmijës.
2. Ngarkohen Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që, në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit, ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

12. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për kamatë-vonesat në transaksionet tregtare

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni FunkSIONAL e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

Ministrja e Tregtisë dhe e Industrisë, znj. Hykmete Bajrami, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi Projektligjin për kamatë-vonesat në transaksionet tregtare.

Kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin e këtij projektligji.

Lidhur me Projektligjin për kamatë-vonesat në transaksionet tregtare diskutuan: në emër të Komisionit FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, Muhamet Mustafa, në emër të GP të PDK-së, Sala Berisha-Shala dhe në emër të GP të LDK-së, Fatmir Rexhepi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Ky projektligj është votuar në vazhdimin e seancës plenare më 5 gusht 2016.

Kryetari e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.

Rezultati i votimit ishte si në vijim:

Për -----69,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi njëzëri

V E N D O S I:

1. Miratohet në parim Projektligji për kamatë-vonesat në transaksionet tregtare.
2. Ngarkohen Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që, në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit, ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

Në fillim të vazhimit të seancës plenare më 5 gusht 2016, deputetja Blerta Deliu-Kodra e paraqiti për miratim një tekst të Deklaratës, me të cilin deputetët e Kuvendit e dënojnë sulmin që kishte ndodhur mbrëmë mbi Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Kryetari kërkoi deklarinimin e kryetarëve të grupeve parlamentare lidhur me propozim-deklaratën e paraqitur nga deputetja Blerta Deliu-Kodra.

Lidhur me propozim-deklaratën e paraqitur nga deputetja Blerta Deliu-Kodra diskutuan: Adem Grabovci, Armend Zemaj, Rexhep Selimi, Valdete Bajrami, Muhamet Mustafa, Nuredin Ibishi, Vjosa Osmani, Besim Beqaj, Besa Gaxheri, Ismajl Kurteshi, Arben Gashi, Adem Salihaj, Glauk Konjufca, Albin Kurti, Bardhyl Metaj, Ismet Beqiri, Shukri Buja, Sabri Hamiti, Selvije Halimi, Albulena Haxhiu, Srgjan Popoviq, Kujtim Paçaku, Slavko Simiq, Melihate Tërmkolli, Qerim Bajrami dhe Hajdar Beqaj, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari kërkoi nga grupet parlamentare që ta harmonizojnë tekstin e deklaratës dhe Kuvendit t’ia paraqesin për miratim.

Pas konsultimeve ndërmjet grupeve parlamentare, deputetja Blerta Deliu-Kodra e paraqiti tekstin e deklaratës të harmonizuar me grupet parlamentare.

Kryetari e hodhi në votim miratimin e deklaratës.

Rezultati i votimit ishte si në vijim:

Për -----	68,
Kundër-----	0,
Abstenime-----	0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi njëzëri miraton këtë:

D E K L A R A T Ë

Ne përfaqësuesit e zgjedhur të popullit e dënojmë fuqishëm sulmin kriminal, të kryer mbrëmë mbi Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Ky është një sulm kundër shtetit të Kosovës, interesave të qytetarëve tanë dhe kundër qëllimeve dhe vlerave politike e demokratike që afirmojnë subjektet tona politike.

Kërkojmë nga institucionet e sigurisë që t’i ndërmarrin masat e duhura dhe sa më parë ta zbardhin këtë sulm qyqar, ndërsa kriminelët të vihen para drejtësisë.

Kuvendi i Republikës së Kosovës po ashtu u bën thirrje të gjithë qytetarëve të vendit që të bashkëpunojnë dhe t’i ndihmojnë organet e drejtësisë në zbardhjen e këtij akti kriminal.

13. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për kundërvajtje

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni Funksional e ka rishqyrtuar Projektligjin për kundërvajtje dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Në këtë projektligj ishin propozuar 32 amendamente nga Komisioni Funksional.

Nuk pati asnjë diskutues lidhur me amendamentet e propozuara.

Kryetari i hodhi në votim të gjitha amendamentet, nga 1 deri 32, përnjëherë.

Kuvendi i miratoi të gjitha amendamentet e propozuara nga Komision Funksional.

Pastaj, kryetari e hodhi në votimi tekstin e projektligjit me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për -----	71,
Kundër-----	0,
Abstenime-----	0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi njëzëri

V E N D O S I:

Miratohet Projektligji nr. 05/L-087për kundërvajtje.

14. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara

Kryetari i njoftoi deputetët se komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Në këtë projektligj ishin propozuar 5 amendamente nga Komisioni Funksional.

Nuk pati asnjë diskutues lidhur me amendamentet e propozuara.

Kryetari i hodhi në votim të gjitha amendamentet, nga 1 deri 5, përnjëherë.

Kuvendi i miratoi të gjitha amendamentet e propozuara nga Komision Funksional.

Pastaj, kryetari e hodhi në votimi tekstin e projektligjit me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për -----	71,
Kundër-----	0,
Abstenime-----	0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi njëzëri

V E N D O S I:

Miratohet Projektligji nr. 05/L-078 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-019 për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara.

15. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për rregullat e komunikacionit rrugor

Kryetari i njoftoi deputetët se komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për rregullat e komunikacionit rrugor dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Raportin e Komisionit Funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri e paraqiti raportuesi i komisionit, Raif Qela.

Në këtë Projektligj ishin propozuar 263 amendamente nga Komisioni Funksional.

Lidhur me amendamentet e propozuara diskutuan: Muhamet Mustafa, Nuredin Ibishi dhe Besim Beqaj, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryetari i hodhi në votim të gjitha amendamentet, nga 1 deri 263, përnjëherë.

Kuvendi i miratoi 263 amendamentet e propozuara nga Komision Funksional.

Pastaj, kryetari e hodhi në votimi tekstin e projektligjit me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për -----72,

Kundër----- 0,

Abstenime----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi njëzëri

V E N D O S I:

Miratohet Projektligji nr. 05/L-088 për rregullat e trafikut rrugor.

16. Shqyrtimi i raportit vjetor të Qeverisë së Republikës së Kosovës për funksionimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike në Sektorin Publik të Kosovës për vitin 2015

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni Funksional për Mbikëqyrjen e Financave Publike ka shqyrtuar raportin vjetor të Qeverisë së Republikës së Kosovës për funksionimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike në Sektorin Publik të Kosovës për vitin 2015 dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij, bashkë me rekomandimet e propozuara.

Ministri i Financave, Avdullah Hoti, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi raportin vjetor të Qeverisë së Republikës së Kosovës për funksionimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike në Sektorin Publik të Kosovës për vitin 2015.

Raportin e Komisionit FunkSIONAL për Mbikëqyrjen e Financave Publike e paraqiti dhe e arsyetoi deputeti Fikrim Damka.

Lidhur me raportin vjetor të Qeverisë së Republikës së Kosovës për funksionimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike në Sektorin Publik të Kosovës për vitin 2015 diskutuan: në emër të GP të PDK-së, Naim Fetahu, në emër të GP të LDK-së, Ali Sadriu, në emër të GP të LVV-së, Besa Baftija, si dhe deputetët: Shukri Buja, Avdyl Ymeri dhe Hajdar Beqaj, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryetari e hodhi në votim miratimin e këtij raporti.

Rezultati i votimit ishte si në vijim:

Për -----55,
Kundër----- 9,
Abstenime----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash

V E N D O S I:

Miratohet raporti vjetor i Qeverisë së Republikës së Kosovës për funksionimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike në Sektorin Publik të Kosovës për vitin 2015, me rekomandimet e Komisionit FunkSIONAL.

17. Shqyrtimi i raportit të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2015

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar raportin vjetor të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2015 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Lidhur me raportin vjetor të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2015 diskutuan: në emër të Komisionit FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa, Besa Gaxheri dhe në emër të GP të PDK-së, Mexhide Mjaku-Topalli, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryetari e hodhi në votim miratimin e këtij raporti.

Rezultati i votimit ishte si në vijim:

Për -----53,
Kundër----- 8,
Abstenime----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash

V E N D O S I:

Miratohet raporti vjetor i Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2015.

18. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për mbrojtje nga dhuna në familje

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione e ka mbikëqyrur zbatimin e Ligjit për mbrojtje nga dhuna në familje dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime.

Në emër të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, deputetja Mexhide Mjaku-Topalli e paraqiti dhe e arsyetoi raportin me rekomandime.

Lidhur me raportin e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për mbrojtje nga dhuna në familje diskutuan: në emër të GP të PDK-së, Salihe Mustafa, në emër të GP të LDK-së, Lirije Kajtazi, në emër të GP të LVV-së, Besa Baftija, në emër të GP “6+”, Mufera Shinik, si dhe deputetët: Njomza Emini dhe Salih Morina, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryetari e hodhi në votim miratimin e këtij raporti.

Rezultati i votimit ishte si në vijim:

Për -----	67,
Kundër-----	0,
Abstenime-----	0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi njëzëri

V E N D O S I:

Miratohet raporti me rekomandime i Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për mbrojtjen nga dhuna në familje.

19. Propozimi i GP të PDK-së për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare

Kryetari i njoftoi deputetët se Grupi Parlamentar i PDK-së ka propozuar zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare.

Kryetari kërkoi nga deputetët që me ngritje dore të deklarohen për propozimin e GP të PDK-së.

Kryetari konstatoi se Kuvendi njëzëri

V E N D O S I:

I. Nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës bëhet zëvendësimin i anëtarëve në komisionet parlamentare si në vijim:

1. Deputeti Elmi Reçica emërohet kryetar i Komisionit për Punë të Jashtme, në vend të ish-deputetit Enver Hoxhaj.
2. Deputetja Luljeta Veselaj-Gutaj emërohet anëtare në Komisionin për Punë të Jashtme.
3. Deputeti Fatmir Xhelili emërohet anëtar në Komisionin për Integritet Evropian, në vend të deputetes Luljeta Veselaj-Gutaj.
4. Deputeti Shukri Buja emërohet anëtar në Komisionin për Buxhet dhe Financa, në vend të deputetit Adem Grabovci.

Kryesuesi i mbylli punimet e seancës plenare më 5 gusht 2016, në orën 15:20 minuta.

Kryetari i Kuvendit:

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale